



Bibël për fëmijët
paraqet

Kur Perëndia Krijoi
Gjithçka



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus

Adaptuar nga: Bob Davies; Tammy S.

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi


Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2014 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Kush na ka krijuar ne? Bibla, Fjala e Perëndisë na tregon fillimin e njerëzimit. Shumë kohë më parë, Perëndia e krijoi njeriun e parë dhe e quajti atë Adam.



Perëndia e krijoi Adamin prej pluhurit të tokës.
Kur Perëndia fryu frymë jete tek Adami, ai filloi të
jetojë. Adami e filloi jetën e tij, në një kopësht të
bukur të quajtur Eden.




Përpara se të krijonte Adamin, Perëndia krijoi një botë plot bukuri dhe gjëra të mrekullueshme. Perëndia krijoi një nga një, kodrat, lëndinat, lulet aromë-këndshme, pemët e larta, zogjtë pendëndritur, bletët punëtore, balenat rookullisëse dhe kërmijnjtë rrëshqitës. Në të vërtetë,

Perëndia krijoi gjithçka që ekziston - gjithçka.



Në fillim fare, përpara se
Perëndia të krijonte gjithçka,
nuk kishte asgjë; ishte vetëm
Perëndia. Nuk kishte
as njerëz, as vende
dhe as sende. As
dritë, as errësirë.
As lartësi dhe as
vende të ulëta.
As ditë të djeshme
dhe as të nesërme.
Ishte vetëm Perëndia,
i Cili nuk ka fillim.
Por, Perëndia veproi.



Në fillim,
Perëndia krijoi
qiejt dhe tokën.




Dhe toka ishte e zbrazët
dhe pa formë. Dhe
errësira mbulonte
sipërfaqen e
humnerës.


Pastaj
Perëndia
foli. "Le
të ketë
dritë".



Dhe drita u krijua. Perëndia e quajti dritën Ditë;
dhe errësirën Ai e quajti Natë. Dhe pas mbrëmjes
erdhi mëngjesi; dita e parë.





Në ditën e dytë, Perëndia i ndau ujërat e oqeanëve, deteve dhe liqeneve, nga ujrat e kupës qiellore. Në ditën e tretë, Perëndia tha: "Le të shfaqet toka e thatë". Dhe kështu u bë.



Perëndia urdhëroi gjithashtu, që të shfaqen bari,
lulet dhe pemët. Dhe pas mbrëmjes
erdhi mëngjesi; dita
e tretë.




Pastaj, Perëndia krijoi diellin
dhe hënën dhe kaq shumë yje sa
askush nuk i numëron dot. Dhe
pas mbrëmjes erdhi mëngjesi;
dita e katërt.




Më pas Perëndia krijoi gjallesat detare, por edhe peshqit dhe zogjtë. Në ditën e pestë, Perëndia krijoi peshqit e mëdhenj shigjetarë, strucat këmbëgjatë, dhe trumcakët e vegjël e të lumtur. Perëndia krijoi çdo lloj peshku për të mbushur ujrat e tokës; Perëndia krijoi gjithashtu edhe çdo lloj zogjsh për të mbushur me cicërima gëzimi qiellin, detin dhe tokën. Dhe pas mbrëmjes erdhi mëngjesi; dita e pestë.



Mbas kësaj, Perëndia foli sërish. Ai tha:
"Le të prodhojë toka qenie të gjalla...". Dhe
kështu u krijua çdo lloj kafshësh, insektesh
dhe zvarranikësh. Elefantët që tundin tokën dhe
urithët që nuk pushojnë së gërmuari. Majmunët
mistrecë dhe krokodilët nofullmëdhenj. Krimbat e
veckël dhe ketrushat lozonjarë. Gjirafat qafëgjata
dhe macet trozovaçe. Të gjitha kafshët e të gjitha
llojeve, u krijuan nga Perëndia atë ditë.



Dhe pas mbrëmjes erdhi mëngjesi;
dita e gjashtë.



Por, kë tjetër krijoi Perëndia ditën e gjashtë? Dikë shumë të veçantë. Po! Tani që gjithçka ishte gati, Perëndia krijoi njeriun. Ushqimi në fusha dhe kafshët ishin gati për ti shërbyer atij. Dhe

Perëndia tha "Le ta krijojmë njeriun sipas ngjasimit Tonë; dhe le të sundojë Ai mbi gjithë peshqit e detit, zogjtë e qiellit dhe përmbi gjithë kafshët dhe rrëshqanorët tokës."



KËSHTU, PERËNDIA E KRIJOI NJERIUN
SIPAS SHËMBËLLTYRËS SË TIJ; SIMBAS
SHËMBËLLTYRËS SË TIJ E KRIJOI AI ATË...



Dhe Perëndia i
tha Adamit: "Ha
gjithçka që të
pëlqen nga kopshti,
por jo nga pema e
nohjes së të mirës
dhe të së keqes.
Ditën që do të
hash nga ajo pemë,
me siguri do të
vdesësh".



Dhe Zoti Perëndi tha, "Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm. Unë do të krijoj një ndihmë të përshtatshme për të". Perëndia kishte sjellë tek Adami të gjithë zogjtë dhe bishat, që ai tu vinte emra atyre; por, nuk kishte asgjëkundi një ndihmë të përshtatshme për Adamin.



Kështu, Perëndia e vuri
Adamin në një gjumë shumë
shumë të thellë. Perëndia e
formoi Gruan, duke marrë
një nga brinjët e Adamit.
Gruaja që Perëndia krijoi,
ishte pikërisht ajo që i
duhej dhe i përshtatej
Adamit.



Perëndia krijoi gjithçka në gjashtë ditë.
Pastaj, Perëndia e bekoi ditën e shtatë
dhe e bëri atë një ditë pushimi. Në
kopshtin e Edenit, Adami dhe Eva kishin
lumturi të përsosur duke iu bindur
Perëndisë. Perëndia, ishte ZOTI,
Parashikuesi dhe Miku i tyre.



Kur Perëndia Krijoi Gjithçka

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Zanafilla 1-2

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

